




FKPKK

Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale, Shqipëri

www.fkpkk.org

Kurora e Gjelbër



APPK

Asosacioni i Pronarëve të Pyjeve Privatë, Kosovë

www.akppp.org

Gazetë Periodike, Tiranë (Viti i katërbëdhjetë i botimit) Nr. 112, Janar 2012 Çmimi 20 lekë

Berisha: Duhet gjetur mekanizmat për të privatizuar pyjet

Pyjet do t'i bëjmë me zot



Nën drejtimin e kryeministrit Berisha u zhvillua takimi me pjesëmarrjen e ministrit dhe institucioneve të ngarkuara për zbatimin e procesit të transferimit të pyjeve e kullotave në varësi të pushtetit vendor, me qëllim përsheptimin dhe realizimin me sukses të këtij procesi.

Duke e vlerësuar takimin të rëndësishëm për rakordimin e mëtejshëm të hapave që do të ndërmerren nga institucionet përkatëse, kryeministri Berisha përgëzoi Ministrinë e Mjedisit për përpjekjet e mëdha e serioze në përmirësimin e praktikave të menaxhimit, të trajtimit, të qëndrimit ndaj këtij problemi të rëndësishëm për çdo vend.

Kryeministri bëri të ditur se gjatë 5-6 viteve të fundit janë transferuar në pronësi të pushtetit lokal rreth 800 mijë ha pyje e kullota ose 50% e fondit të tyre. Duke e vlerësuar pozitive përvojën e administrimit të pyjeve e kullotave nga pushteti vendor, Kryeministri theksoi se mbetet ende një punë e madhe për të bërë në drejtim të përmirësimit e konsolidimit të mëtejshëm të kësaj eksperience. "Pyjet janë pasuri e madhe kombëtare e çdo vendi. Sot ato marrin rëndësi të

jastëzakonshme, kur planeti përballet me ndryshime të mëdha të klimës dhe faktikisht pyllëzimi e pyjet janë një levë e fuqishme për të mundur që të ndikohet në zvogëlimin e pasojave të rënda të kësaj dukurie", u shpreh Kryeministri.

Kryeministri kërkoi nga ministria përkatëse dhe institucionet e lidhura me të, që ky të jetë viti i zgjidhjes përfundimtare, në vija të përgjithshme, të problemeve të pronësisë së pyjeve. Ai u shpreh se është shumë i rëndësishëm përcaktimi sa më parë i sipërfaqeve pyjore, që do të mbeten publike, duke theksuar se qeveria qendrore nuk mund të administrojë më shumë se 10% të pyjeve në të gjithë vendin. "Qeveria nuk do të mund të ketë më shumë se 10% të pyjeve. U takon ju, së bashku me institucionet e varësisë, të përzgjidhni këtë 10% se cila do të jetë, por më shumë se kaq nuk mund të administrojë. Ky është një standard kudo në vendet e BE. Ky standard është që pyjet u përkasin komunave e bashkive.", u shpreh kryeministri.

Ndër të tjera, Kryeministri evidentoi se është shumë e rëndësishme gjetja e mekanizmave sa më të përshtatshme e transparente për privatizimin e pyjeve, por njëkohësisht edhe për mbrojtjen e zhvillimin e tyre, duke vendosur disiplinë më të fortë për menaxhimin. "Unë shpresoj që ju të përpunoni një skemë jo vetëm

të kthimit në të gjitha rastet të pyjeve tek të zotët, atje ku ka pronar, por unë do t'u vlerësoja shumë nëse do të gjeni mekanizma transparente të privatizimit të pyjeve, pra ti bëjmë pyjet me zot. Sigurisht, duke vendosur së bashku disiplinën më të fortë në menaxhimin e tyre. Pra të gjejmë mekanizmat më eficientë të mbrojtjes dhe të zhvillimit të tyre", tha kryeministri. Në këtë vështrim, kryeministri kërkoi që të përcaktohet një skemë, duke u bazuar edhe në ekspertizën e vendeve më të suksesshme në këtë drejtim. "Do të vlerësoja shumë që ju me ekspertizën, edhe të huaj, të mund të përcaktoni një skemë, që ne të ecim me kthimin e shpejtë të këtyre pronave, pronarëve".

Duke vlerësuar se çdo sipërfaqe toke në vendin tonë mund të shfrytëzohet për mbjellje, kryeministri theksoi se duhen bërë të gjitha përpjekjet për të zhvilluar konceptin e pyjeve me drurë frutorë. "Duhet të përpiqemi të zhvillojmë konceptin e pyjeve me drurë frutorë. Ky koncept dorë-dorës po merr zhvillim edhe në botë. Kjo metodë pyllëzimi po fiton gjithnjë e më tepër të drejtën e qytetarësisë. Ne do të bëjmë gjithçka, që ku të mbillet të prodhohet".

Duke ritheksuar nevojën e transferimit sa më të shpejtë të pyjeve e kullotave pushtetit vendor, si dhe përsheptimin e procesit të privatizimit të pyjeve, kryeministri tha se do të bëhen të gjitha përpjekjet që viti 2012 ta gjejë Shqipërinë një nga vendet me pronësitë publike më të ulëta në Evropë.

"Bjeshkët e Namuna", strehë e eposit të lashtë

NIJAZI IDRIZI

Deputet në Kuvendin e Kosovës

Vendi ynë, Kosova, ka një sipërfaqe të vogël, por me një varg veçantish e specifkash të veta, ndër të cilat janë edhe Bjeshkët e Namuna. Këto male shtrihen, duke filluar nga rrjedha e lumit Ibër, në veri e deri te Qafa e Morinës, në jug, ndërsa në lindje kufizohen me viset e rrafshëta të Dukagjinit.



Bjeshkët e Namuna përbëhen nga male të larta, që arrijnë edhe mbi 2500 m nga rrafshi i detit. Maja më e lartë është Gjeravica (2656 m), ndërsa pak më të ulëta janë, ajo e Lumbardhit (2522 m), Ropsit (2502 m), Koprivnikut (2460 m), Hajlës (2400 m), etj. Këto male, në mes tyre janë të ndara me gryka të thella të lumenjve, siç janë, ajo e

Vijon në fq. 2

Kryeministri Berisha, intervistë në "abc news"

Në një intervistë ekskluzive për "ABC News", kryeministri Berisha bëri një panoramë të gjatë të zhvillimeve ekonomike e politike për vitin që lamë pas dhe për muajt në vijim. Kreu i qeverisë tha se vendi i kaloi pritshmëritë. Madje, në këtë intervistë ai zbardhi dhe moton e qeverisë për konsolidimin Jeshil të Shqipërisë. Edhe prononcimi i tij për pasuritë pyjore të vendit ishte mjaft i rëndësishëm. Në këtë vështrim, për t'u veçuar ishin:

- Problemet më të mëdha i kemi me pyjet.
- Nuk ka vend në botë me pasuri publike sa Shqipëria!
- Do të privatizojmë pyjet dhe Pyjet do t'i bëjmë me Zot!
- Të menaxhohen (pyjet) më mirë dhe të krijohen të ardhura ...

Koment i Bordit të FKPKK



Bordi i Federatës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave Komunale shpreh dhe njëherë falënderimin e veçantë për Kryeministrin Berisha, i cili ka mbështetur në vazhdimësi procesin e decentralizimit, si dhe po synon ndreqjen e padrejtësive historike që janë bërë mbi këto

Vijon në fq. 5

Proces që duhet vlerësuar e menaxhuar me përgjegjësi e profesionalizëm

Prof. Dr. ARSEN PROKO



Vizioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, mishëruar tek strategjia dhe politikat e zhvillimit të pyjeve, synon pyllin për njerëzit, të mirat e jetës dhe çrrënjosjen e varfërisë.

Reformimi i pylltarisë shqiptare ecën drejt një rrugë të përcaktuar dhe të bërë publike nëpërmjet strategjive dhe programeve të qeverisë. Ajo zhvillohet në harmoni me strategjitë globale dhe evropiane.

Qeveria Shqiptare procesin e decentralizimit dhe transferimit e kompetencave drejt pushtetit vendor e ka pasur një parim drejtues. Kryeministri ne fjalën e tij bën thirrje për përsheptim të procesit të transferimit/privatizimit.

Ndërkohë, debati mbi suksesin ose dështimin e reformës mbi transferimin e pyjeve dhe

Vijon në fq. 2

Ti bëjmë pyjet me Zot, rruga e vetme për të mbrojtur pyjet e shtuar të ardhurat për njerëzit më të varfër në vëndin tonë

REXHEP NDREU, Federata Kombëtare e PKK, Tiranë

Tanimë, në shkallë vendi janë mbi 240 shoqata të përdoruesve të pyjeve, të cilat në nivel rajonesh janë organizuar në Federatë (deri tani në 10 qarqe), me mision kryesor mbështetjen për të rritur kapacitetin e Shoqatave dhe Komunave me trajnime e asistencë teknike, si dhe të mbrojnë interesat e tyre për pronën dhe të drejtat për përdorimin e saj. Në shkallë vendi është

Vijon në fq. 5

Proces që duhet vlerësuar e menaxhuar me përgjegjësi e profesionalizëm

Vijon nga fq. 1

krijimin e pylltarisë me bazë komuniteti, një nga reformat me të rëndësishme në sektorin pyjor, endë vazhdon, megjithëse ka rreth pesë vjet që procesi zhvillohet intensivisht. Ky debat më tepër se kurë hapet tani kur Kryeministri deklaroi për një transferim/privatizim të shpejtë të rreth 90 % të pyjeve e kullotave të vendit.

Skeptikët japin argumentet e tyre, duke thënë se komunat nuk kanë kapacitete profesionale, financiare e logjistike për të siguruar menaxhim të qëndrueshëm e të harmonizuar të pyjeve, duke kënaqur kërkesat ekologjike, sociale dhe ekonomike. Këtë ata e argumentojnë me predispozicionin e ulët të kryetarëve të komunave për të krijuar stafin pyjor, databazën pyjore dhe se akoma nuk e kanë bërë këtë pasuri pjesë të planifikimit e vlerësimit ekonomik. Mbi të gjitha, ka një dëshirë të ulët për ta transferuar në mënyrë të drejtë e të ndershme pyllin tek përdoruesi i fundit, fshati, fisi apo familja. Një pjesë përmendin gabimet teknike të bëra si rezultat i nxitimit. Nuk ka aksione të përmasave të tilla pa gabime. Ndonjë përmirësim të situatës ata e justifikojnë me zbrazjen e fshatit dhe uljen e numrit të blegtorisë.

Optimistët japin argumentet e tyre, duke marrë shembuj nga Lugina e Matit, Shkumbinit, Devollit, ku vihet re ripërtëritje luksuriante e pyjeve, si dhe përfshirje të komuniteteve e shoqatave të përdoruesve në përpjekjet për të zhvilluar pylltarinë me bazë komuniteti. Ata përdorin konkluzione analizash e treguesish të bëra edhe nga ekspertë të huaj, që tregojnë përmirësime të ndjeshme në rritjen e pyjeve dhe uljen e pre-rjeve e tregtisë ilegale. Duke siguruar pjesëmarrjen e më shumë aktorëve në menaxhimin e pyjeve, s'ka dyshim që dhe përfitimet që kanë pasur shtresat e popullsisë rurale, jeta e të cilëve varet tek pyjet, kanë qenë të ndjeshme.

Ndërkohë, shoqëria civile, organizatat e shoqatave ambientaliste, media e akademja, të interesuara e shqetësuara për funksionet ekologjike të pyjeve e sidomos ata që njohin rolin e tyre në ngrohjen globale, sekuestrimin e karbonit, ruajtjen e sasisë e pastërtisë së ujërave, kontrollin e erozionit e reduktimin e varfërisë, me shqetësim pyesin se çfarë po ndodh e do të ndodhë me këtë pasuri kombëtare. Do shkojë ajo drejt përmirësimit apo drejt degradimit të mëtejshëm?

Duke arsyetuar me mendje të ftohtë e pa komplekse, le të përpiqemi të argumentojmë atë që po ndodh në të vërtetë. Thuhet rëndom se reforma transferon "të drejtën e pë-

rdorimit të pyjeve" te komuniteti. Të gjithë e kanë të qartë se komuniteti, historikisht, e ka përdorur dhe vazhdon ta përdorë pyllin, atëherë del se ne po i transferojmë "të drejtën ...". Kjo do të thotë se i japim të drejtën komunitetit ta përdorë pyllin "ditën me diell e jo natën pa hënë". Po ashtu, i nxjerrim ndrojtjen e deklarimit të asaj që përdor, tashmë me të drejtë. Kështu formalizojmë përfundimisht një sektor që deri tani ka qenë joformal, duke evidentuar peshën reale të sektorit në zhvillimin rural dhe uljen e varfërisë. Thënë ndryshe, transferojmë te komuniteti detyrimin për ta mbrojtur pyllin nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm dhe përdorimit racional të lëndës së drurit.

Procesi i vazhdimin të reformës për konsolidimin e pylltarisë komunale drejt sigurimit të të drejtës zakonore të përdorimit të pyjeve, është theme-lore për arritjen e standardeve dhe suksesit të dëshiruar e të shumëpritur nga të gjithë.

Mendoj se përshpejtimi i reformës në sektorin e pyjeve nxit zhvillimin rural dhe atë ekonomik, ndikon ndjeshëm në reduktimin e varfërisë dhe afron suksesin dhe përmbushjen e standardeve evropiane. Ajo kërkon qëndrim e sjellje krejt të re, duke nxjerrë nga agonia e plogështia edhe vetë shërbimin pyjor kombëtar, duke e bërë atë më profesional dhe duke e afëruar më afër njerëzve. Kjo reformë mundësitë për kërkim, zhvillim teknologjike e inovacion, i shndërron në domosdoshmëri.

Pylltaria shqiptare po ecën drejt një reformimi të thellë, që siguron njëherësh jo vetëm zgjidhjen e të drejtës zakonore të përdorimit të pyjeve, formalizimit të sektorit të pyjeve, por edhe krijimin e një shërbimi pyjor modern e të standardeve evropiane.

Ka kaq shume eksperiencia dhe praktika të mira sa nuk është e nevojshme të shkojmë në rrugë të pashkelura. MMPAU dhe DPK do hartojnë skema e skenarë që do trajtohen me transparencë maksimale me publikun dhe grupet e interesuara. Ky proces është jetik për krijimin e një vizioni të përbashkët dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve në të.



"Bjeshkët e Namuna" strehë e eposit të lashtë

Vijon nga fq. 1

NIJAZI IDRIZI



Lumbardhit të Pejës, të Deçanit, etj., të formuara jo vetëm nga lëvizjet tektonike në periudhat e ndryshme gjeologjike, po edhe nga veprimet e akullnajave. Ndër akullnajat më të njohura ka qenë ajo e Pejës, nga e cila është formuar gryka e Rugovës, me një bukurri mahnitëse në tërë gjatësinë e saj prej 25 km. Nga po të tilla akullnaja në pjesët e larta malore, janë krijuar shumë liqene glacialë, ndër të cilët më të njohur janë, ata të Leqinatit dhe Gjeravicës, të cilët shquhen me bukuritë magjepsëse të tyre.

Këto Bjeshkë, karakterizohen me forma tipike glaciale, karstike e fluviale dhe janë malet më glacialë jo vetëm të Ballkanit, po edhe Evropës së Mesme. Ato, së bashku me bjeshkët që shtrihen në Shqipëri, Amy Boue i quajti Alpet shqiptare (për shkak të ngjashmërisë me Alpet zvicerane). Ky emërtim, kohëve të fundit po përdoret shumë shpesh nga ekspertët e huaj.

Vlerat e larta natyrore të këtyre bjeshkëve i kanë shtyrë shumë studiues të huaj, që të vijnë e të bëjnë hulumtime në këtë rajon. Ndër ta po përmendim vetëm disa nga më të shquarit për përkushtim, si: Amy Boue, August Grisebach, Kurt Hasert, Emil Tiefze, etj.

Bjeshkët e Namuna, për sa i përket florës e faunës, paraqesin masivin më të rëndësishëm e më interesant. Aty (sipas studimeve të deritashme) gjenden mbi 1500 lloje bimësh, shumë nga të cilat janë lloje relikte, si: *Acer heildreichii*, *Asyneuma trichocalicinum*, *Campanula lingulata*, *Cardamine glauca*, etj. Po ashtu edhe fauna, përbëhet prej 8 lloje peshqish, 13 lloje ujëtokësorësh, 10 lloje zvarranikësh, 148 lloje shpendësh, 36 lloje gjitarësh (pa llogaritur lakuriqët), 129 lloje fluturash nga rendi *Lepidoptera*, etj., një numër i të cilave nuk mund të gjenden në asnjë vend tjetër.

Në territorin e Bjeshkëve të Namuna, deri tani janë disa zona të mbrojtura të kategorisë së rezervateve strikte të natyrës, rezervateve të natyrës, përmendoreve natyrore dhe parqeve memorialë:

- Rezervati Maja e Ropsit (25 ha), me ekzemplarë të ruajtur të arnenit, bredhit, pishës e ahut. Kozhnjari (161 ha) si rezervat i dhisë së egër (*Rupicapra rupicapra*).

- Rezervati i mbrojtur i Maleve të Prilepit (0.92 ha) që është me përbërje të pastër panje malore (*Acer heildreichii*).
- Rezervati Gubavci (38 ha), ku rritet lloji endemorelikt *Forsythia europaea*.
- Monumenti i mbrojtur i natyrës, Gryka e Rugovës (4301 ha), që paraqet edhe pjesën më piktoreske të Bjeshkëve të Namuna, e cila karakterizohet me shkëmbinj të lartë gëlqerorë të prerë nga Lumbardhi me një numër të madh shpellash.
- Burimi i Drinit të Bardhë (89.94 ha), ku bën pjesë shpella e Radavcit dhe ujëvara e lartë 25 m.
- Maja e Zezë (112.56 ha), etj.



Iniciativa për shpalljen e "Bjeshkëve të Namuna" Park Nacional, ka nisur në vitet '70 nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe ka vazhduar përsëri në vitin 1985 nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Sipas kësaj iniciative, Parku Nacional "Bjeshkët e Namuna" do të përfshinte pjesë të territorit të Komunës së Pejës dhe Deçanit. Në atë kohë, Komuna e Deçanit nuk e pati dhënë pëlqimin, prandaj vetëm pjesa që i takon Komunës së Pejës ishte shpallur dhe atëherë u përgatit "Studimi për arsyeshmërinë e shpalljes së Bjeshkëve në Komunën e Pejës, për Park Nacional".

Në vitin 2002 Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës përsëri mori nismën për t'i shpallur Bjeshkët e Namuna, Park Nacional. Sipas kësaj nisme, ishte paraparë që në Parkun Nacional të përfshihen pjesë të territorit të Komunës së Pejës, Istogut, Deçanit e Gjakovës. Më pas, në vitin 2003,

u përgatit "Studimi për arsyeshmërinë e shpalljes së Bjeshkëve të Namuna "Park Nacional" dhe u hartua edhe projektligji për të.

Këto janë vetëm disa të dhëna të cilat po pasurohen nga studiues të ndryshëm që janë duke i vazhduar hulumtimet në këto hapësira shumë interesante.

Në dimensionin Kombëtar, këto Bjeshkë përfshijnë zona të banuara me shumicë nga shqiptarët në Mal të Zi dhe në të dy vendet e kombit tonë (Kosovë e Shqipëri). Këto Bjeshkë, në të kaluarën, kanë qenë pothuaj të pakalueshme dhe, si të tilla, vazhdojnë të mbeten edhe sot. Shqiptarët e Plavë - Gucisë janë pothuaj të ndarë nga ata të Deçanit, Tropojës e Thethit. Pikërisht në kurrizin e këtyre bjeshkëve është vendosur "perdja e hekurt" (e dyta, pas asaj të Vjenës, për gjermanët), për t'i izoluar e ndarë mu në kurrizin e Atdheut, përfundimisht shqiptarët nga njëri - tjetri dhe për t'u përjetësuar kjo ndarje!

Për shkak të shtrirjes së këtyre Bjeshkëve në Kosovë, Shqipëri e Mal të Zi, del i arsyeshëm edhe angazhim i të tre shteteve, për ta marrë në mbrojtje këtë hapësirë. Para pak vitesh ka pasur një propozim që ajo të merrret në mbrojtje nga këto shtete dhe e njëjta të emërtohet si "Parku i Paqes". Shpallja e kësaj hapësire për zonë të mbrojtur, ofron mundësinë që kjo ndarje të kthehet në të kundërt, në bashkim të banoreve të kësaj hapësire. Është interes kombëtar dhe i integritetit të këtij rajoni që të bashkohen njerëzit e ndarë, duke e çjerrë këtë perde të nëmur.

Me ardhjen e këtij Projektligji në Kuvendin e Kosovës, janë hapur shumë debate dhe kanë dalë në skenë shumë aktorë, të cilët janë ndarë sipas interesave që përfaqësojnë. Debati në mes të palëve në interes, deri tani po bëhet në dy ekstreme: për dhe kundër shpalljes së kësaj zone si Zonë e Mbrojtur. Për çudi, kësaj radhe, segmente të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë e Zhvillimit Rural dhe të popullsisë lokale, janë bërë bashkë. Të parët po e dekurajojnë popullsinë lokale, duke i thënë se ky ligj do ta kufizojë atë në shfrytëzimin e resurseve të veta.

Për çudi, të gjithë po e fshehin faktin se vet njerëzit që jetojnë në ato hapësira janë pjesa më e rëndësishme e biodiversitetit dhe nëse ata kufizohen që të bëjnë jetën e tyre sipas mënyrës së vet, atëherë kemi të bëjmë me prishje të ekuilibrit të jetës në këtë mjedis dhe pikërisht në një situatë të tillë, vet ligji duhet t'i marrë në mbrojtje të gjithë. Për këtë arsye, sfida kryesore e institucioneve mbetet të mendojnë rreth shkallës së kufizimeve që do të caktojnë në përdorimin e këtyre burimeve (ndër më të begatshmet në Ballkan), në njërin anë dhe shfrytëzimit shumëqëllimor të tyre, në anën tjetër. Pra, banorëve duhet të ju ndihmohet për t'i përdorur në mënyrë të qëndrueshme druritë, blegtorinë, frutat e bimët mjekësore. Për më shumë, qeveria që e ka sjellë këtë projektligj, jo vetëm që duhet

Vijon në fq. 3

Në përgjigje të ftesës së FKPKK për të marrë pjesë në debat e kontribuar në hartimin e një Ligji sa më jetëgjatë për pyjet, vijmë mendime e propozime, disa prej të cilave po i sjellim këtë në vijim ...

Redaksia

Komuna Sterblevë:

Stafi teknik në komuna të ketë të drejtat siç ka dhe Shërbimi Pyjor për menaxhimin e Pyjeve në administrim të tij dhe kjo të vendoset në ligjin e ri.

Komuna Lenie Skenderbegas:

Kërkon transferimin e të gjitha pronave në pronësi të tyre, por mungon bashkëpunimi me DSHP për të mundësuar damkosjen në rastet kur kemi shfrytëzime për të plotësuar nevojat tona por dhe për përfitime. Të jepen pyjet dhe kullotat që ne kemi kërkuar zyrtarisht dhe Ministria

e Mjedisit. Në gjendjen që i kemi pyjet nuk kemi mundësi të marrim të ardhura. Të ardhurat që merren të përdoren për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve ...

Komuna Gjocaj:

Janë 12 kompani inertesh që po dëmtojnë masivisht token në territorin e komunës tonë. Duhet të ndalohen këto aktivitete sepse erozioni dëmton masivisht.

Shoqata Ekologjike Elbasan:

Të njësohen të gjitha kompetencat e ekspertëve në Shërbimin Pyjor dhe në atë të Komunës për shërbimet dhe zbatimin e ligjit ...

Komuna Gjinar:

Kërkojmë mbështetje nga Qarku për menaxhimin e tokës bujqësore, sepse pengohet dhe projekti që ne po zbatojmë.

Komuna Poroçan:

Procedura për shkeljet ligjore është e paqartë për funksionet e komunës. Stafi teknik i komunave të ketë kompetenca si ai i DSHP, përfshirë dhe armatimin ...

DSHP, Peqin:

Të ketë kritere për mbjelljen e arroveve në fondin pyjor.

Jurant DIKA

Departamenti i Pyjeve dhe Gjuetisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë Ujore, Maqedoni

Unë kam qenë pjesë e grupit të punës këtu në Maqedoni për hartimin e ligjit për pyjet. Ne bëmë disa gabime, që mendoj se do t'i korrigjojmë me kalimin e kohës. Uroj që ju në Shqipëri të mos bëni të njëjtën gjë. Prandaj, unë rekomandoj që të ketë një diskutim të gjerë dhe një qasje të vërtetë mes pjesëmarrësve për këtë proces.

Komente të rishikuara për ligjin e pyjeve nga Bordi i Federatës Kombëtare

Parimet e përgjithshme

Drejtorja e Përgjithshme e Pyjeve theksoi faktin që ky ligj është një shtyese për integrimin e Shqipërisë në BE dhe si i tillë është në të njëjtën linjë me vendet e tjera të BE. Por kjo nuk është e qartë sepse decentralizimi në ligj është marrë si koncept mjaft i kufizuar. Ligji përsëri i jep kompetenca menaxhimi e kontrolli të njëjtës organizate (DPSHP) (referoju nenit 10).

Ligji nuk shpreh mundësinë e përgatitjes për të ardhmen (vizionin afatgjatë). Përmendet në nenin 1.2 lidhja me strategjinë e pyjeve. Megjithatë, përsëri në ligj nuk del i qartë roli kryesor dhe rëndësia që kanë pyjet. Aty përmendet vetëm menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve (neni 4.1) dhe plotësimi i nevojave e shërbimeve për të cilat ka nevojë komuniteti (neni 4.2). Në ligj ka pamjaftueshmëri ose me saktë mungese të treguesve mbi funksionet kryesore të fondit pyjor ...

Neni 13 nuk është i qartë se për cilat pyje behet fjalë: Gjithë fondi pyjor kombëtare? Në nenin 13.a përmendet specifikisht i gjithë fondi pyjor. Për me tepër, nuk jepen prioritetet dhe nuk qartësohet si dhe kujt pylli mund t'i jepen këto funksione. Pastaj përmenden funksionet që mund të kenë pyjet. Gjithashtu, ligji dëshon për sa i përket sqarimit mbi funksionet publike të pyjeve dhe është konfuz në faktin që pylli publik mund të ketë disa funksione.

Ligji është mbi pyjet por përfshin jo rrallë edhe kullotat në marrëveshjet e tij. Kjo e bën atë konfuz dhe kontradiktor me ligjin ekzistues mbi kullotat.

Në përgjithësi gjithë ligji është shumë i detajuar, prandaj edhe është konfuz e i paqartë. Ligji duhet të përqendrohet në çështjet kryesore: a) fondi pyjor, b) funksionet kryesore (pyjet duhet të mbeten pyje dhe nën menaxhim të qëndrueshëm), c) pronësi

dhe përdorim. Ndarje të strukturës menaxhuese dhe kontrollit ligjor. Pra, **decentralizim të vërtetë dhe delegim të kompetencave.**

Gjithë detajet që kanë të bëjnë me menaxhimin duhet të jenë të përcaktuara në rregullore dhe të deleguara pranë strukturave apo organizmave përkatës.

Fondi pyjor

Përkufizimi dhe përdorimi i terminologjisë për pyjet dhe fondin e pyjeve është shumë i dobët, i paqartë dhe kontradiktor.

Në ligj duhet të përcaktohet qartë për cilën tokë është i vlefshëm. Qartësohet pak në nenin 2.7 por në gjithë ligjin janë përdorur terma të ndryshëm.

Vetëm një shembull: Çfarë është fondi pyjor publik, vendor dhe privat? Kjo është pak konfuze sepse fondi pyjor publik përfshin edhe shtetëror edhe lokal, prandaj çfarë kuptohet me fond pyjor publik, vendor?

Pronësia e pyjeve dhe përdorimi

Neni 9.2 bën të qartë që DPPK kontrollon, qeveris e administron fondin pyjor publik dhe vendor. Kjo nuk është e qartë. Saktësisht, cilat pyje merren parasysh. Kjo duhet të qartësohet, pasi gjithashtu nuk është në një linjë me nenin 15.

Propozime:

1. DPPK dhe strukturat e saj kontrollojnë, qeverisin dhe administrojnë pyjet që janë në pronësi shtetërore dhe që menaxhohen nga shërbimi pyjor.

2. DPPK dhe strukturat e saj kontrollojnë pyjet shtetërore që janë marrë në përdorim nga komunat.

3. Kontrolli, qeverisja dhe administrimi i pyjeve të tjera të behet nga qeverisja vendore dhe pronarët privatë.

4. Monitorimi i situatës së pyjeve dhe kontrolli mbi implementimin e ligjit të behet nga një tjetër strukturë kontrolluese (jo DPPK).

5. Shoqatat e përdoruesve të pyjeve, si struktura menaxhuese, janë përmendur vetëm një herë në ligjin 23. SHPP si strukturë e rëndësishme e përdoruesve të pyjeve si për sa i përket menaxhimit edhe kujdesit dhe mbrojtjes së pyjeve e kullotave komunale duhet të përmenden qartë në ligj (roli dhe pozicioni) ...

6. Në nenin 10 përmendet qeverisja dhe kontrolli i gjithë fondit pyjor kombëtar, përfshirë edhe kullotat. Kjo duhet të qartësohet e specifikohet sipas pronësisë mes shtetit, qeverisjes vendore dhe privatit.

7. Sipas nenit 15.4 edhe pyjet që ndajnë parcelat janë pjesë e fondit pyjor privat. Nëse kjo përfshihet kështu do të thotë që i gjithë menaxhimi i pyjeve duhet të aplikohet në këto pyje, përfshirë edhe bërjen e planit të menaxhimit, kontrollin, menaxhimin, etj. Kjo është e pamundur. Ligji duhet të përcaktojë qartë deri në ç'mase pyjet janë të nevojshme në planin e menaxhimit (referoju nenit 5).

8. Neni 18.1 Miratimi nga Shërbimi Pyjor është i nevojshëm për të gjithë pronarët e pyjeve për të gjitha plantacionet dhe për të gjithë përdoruesit. Kjo e bën procesin shumë burokratik dhe në të njëjtën kohë nuk është në linjë me vendet e BE dhe me decentralizimin. Një shembull mund të jetë: Vetëm miratimi për prerje apo ndërhyrje në një sipërfaqe prej 0.5 ha. Një shtesë mund të jetë që pyjet të mbeten pyje; kur mund të ndryshohet destinacioni i një pylli ai duhet të kompensohet me një sipërfaqe me të njëjtat përmasa.

9. Neni 19.2-4 Marrja në përdorim e pyjeve nga qeverisja vendore. Këtu përmendet përmes një marrëveshjeje nëpërmjet DPPK, por ligji i transferimit

të pasurive të paluajshme ka të tjera procedura për marrjen në pronësi apo në përdorim. Në këtë ligj, me vendim të KM nëpërmjet agjencisë për transferimin e pasurive të paluajshme është i nevojshëm. Kjo është e paqartë.

Komente specifike

• Neni 26: Shfrytëzimi i pyjeve. Sipas përcaktimit ai përfshin përpunimin dhe transportin. Kjo nuk është normale dhe mund të konfliktojë sektorin privat dhe zhvillimet në biznes. Me këtë, ligji i pyjeve përfshin edhe fushat që janë jashtë kompetencave të tij.

• Art. 11.1.h menaxhimi i gjuetisë në të gjithë Shqipërinë? Nuk është në linjë me të drejtat e pronësisë dhe menaxhimit. Prandaj duhet të jetë vetëm për pronat pyjore shtetërore. Disa rregulla gjuetie të tjera duhet të rregullohen në ligjin e gjuetisë.

• Në përgjithësi sektori privat nuk është përfshirë në këtë ligj. Kjo bllokton vetë zhvillimin ekonomik dhe rregullat e duhura.

• Art. 26 Funksion mbrojtës. Kush vendos se kur ky funksion është mbrojtës?

• Art. 35.1 Tarifat: Tarifa për pyjet në pronësi dhe në përdorim nga PL duhen vendosur nga vetë SHPP/Komunë, decentralizim i kompetencave.

• Art. 35.2 Mbledhja e tarifave: Jo dakord që të jetë bashke me DPPK. Kjo duhet të jetë me menaxhuesin e pyjeve. Sepse kjo është në kontradiktë me gjithë statutet dhe rregulloret sipas të cilave këtë rol e kanë SHPP.

Federatat Lezhë, Shkodër, Dibër, Kukës, Elbasan kanë propozuar që në Ligjin e Ri të gjithë individëve, familjeve, që tradicionalisht fshati i nje pronarë, t'u jepen në pronësi pyjet e kullotat, si e vetmja rrugë, që siguron mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm dhe garanton rritje të prodhimit e të ardhura për njerëzit më të varfër në Shqipëri.

Vijon nga fq. 2

“Bjeshkët e Namuna”

t'u japë garanci banorëve të atjeshëm, por duhet të fillojë edhe me ndarjen e subvencioneve e granteve, me qëllim që jeta e banorëve që do të jenë pjesë e Parkut, të përmirësohet. Në një situatë të tillë, këta banorë, do të bëjnë një mrekulli të madhe, do t'i shërbejnë vendit, biodiversitetit dhe zhvillimit global. Kështu, stanet, blegtorja, bletët dhe të



mirat e jetës në këto zona, që mbajtën banorët aty, duhet të vazhdojnë të përbëjnë pjesën më të rëndësishme të Parkut, bashkë me copëzat e kanunit të ngrysur, shenjat e të cilit kanë ngelur këtu,

pranë oxhaqeve e telave të lahutave dhe çiftelive. Stanet, jo vetëm që nuk duhet të ndjehen të kërcënuar, por duhet të shërbejnë si modele të qëndrueshme të infrastrukturës së ardhshme, për të cilat duhet të kujdeset shteti posaçërisht. Këtu duhet të strehohet edhe më mirë edhe eposi i lashtë i traditës tonë, si pjesa më e rëndësishme e biodiversitetit, e cila është gllabëruar në shumë vende, nga rokendrolli, jazi e rapi.

Ministria e Mjedisit, me të gjitha palët e interesit, duhet të

vendosë kritere shumë të qarta për zonimin e Parkut. Shpallja e kësaj zone Park, duhet të ketë objektiv të parë përmirësimin e jetës së banorëve vendas. Institucionet duhet ta kenë të qartë se këto burime natyrore janë në radhë të parë për banorët e asaj ane. Me debat të hapur e transparencë të plotë, duhet të vendosen të gjitha zonat e paarrtshme, në zonën strikte të mbrojtjes. Këto hapësira përmbajnë pasuri të biodiversitetit dhe ato realisht nuk i cenojnë të

drejtat e pronësisë së banorëve. Duhet të theksojmë shembullin e Shqipërisë, ku në dhjetor të vitit 2011, është shpallur parku kombëtar Korab - Koritnik, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 55 550 ha. Zona e parë e mbrojtjes, që bllokohet nga aktivitetet është 4.374 ha ose më e vogël se 8 % nga sipërfaqja e përgjithshme. Kjo zonë është veçuar si zonë me vlera të larta të biodiversitetit dhe është parashikuar mbrojtja e

Vijon në fq. 4

Regjistrimi i pyjeve dhe kullotave, proces që nuk duhet zvarritur

Dr. Kristaq QIKO
Msc. Gjon FIERZA

“Procesi i Regjistrimit Fillestar është FALAS për të gjithë pronarët dhe personat që kanë të drejta mbi pasuritë e paluajtshme”. Është ky një njoftim i përhershëm në të gjitha afishimet publike që bën Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme kur bën regjistrimin fillestar të një zone kadastrale. Po, a dihet kjo nga të gjithë, si mund të realizohet dhe si duhet të bashkëpunojnë palët? Mund të ketë dhe mjaft pyetje të tjera për këtë proces, që deri tani thuajse nuk është kryer fare.

Në stadin aktual të zhvillimit të Shqipërisë, regjistrimi i pasurive të paluajtshme, përfshi pyjet e kullotat, merr rendësi gjithnjë e më të madhe në zhvillimet ekonomike. Pyjet dhe kullotat, si pasuri me të cilat është e lidhur ngushtë jeta e banorëve në zonat rurale, nuk janë të futura në sistemin regjistrimit të pasurive (SRPP) si pasuri shtetërore, komunale dhe as ato private. Që këto pasuri të menaxhohen më mirë dhe të rriten të ardhurat ekonomike, qysh nga viti 2008, sipas vendimeve të veçanta të Këshillit të Ministrave, nga rreth 315 NJQV janë marrë në pronësi rreth 600 000 ha pyje dhe rreth 140 000 ha kullota.

Në Shqipëri është i ngritur dhe funksion një sistem i regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Mbështetur nga donatorë ndërkombëtarë, si një ndër reformat kryesore të konsolidimit të shtetit, ka arritur të bëhet përgjithësisht një regjistrim fillestar i tokës bujqësore, trojeve dhe banesave. Sistem ky që është vërtetuar se funksion dhe nga viti në vit po përmirësohet. Pyjet dhe kullotat, pronë shtetërore apo komunale, nuk janë futur në këtë sistem, sot ato rezultojnë të paregjistruara si pasuri të pa-

luajtshme. Fondi pyjor dhe kulloror shqiptar është i pasqyruar vetëm në kadastrën pyjore, e cila përveç pasaktësive që ka nga moskryerja e inventarizimeve periodike 10 vjeçare, në formën që ofrohet, ajo nuk mund të përdoret nga sistemi i ngritur për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, pa kryer disa ndërhyrje të karakterit teknik e administrativ për adaptimin e saj me sistemin unik të regjistrimit. Po kalojnë gati katër vite nga procesi i transferimit e pothuaj asnjë NJQV nuk ka kryer regjistrimin e pyjeve dhe kullotave. Një ndër pikat e Vendimit të KM për çdo rast transferimi, është dhe regjistrimi i tyre, ku janë të ngarkuar dhe strukturat përkatëse Vendore, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Kryeregjistruesi i Shqipërisë. Pra, akoma këto pasuri nuk janë formalizuar si pasuri të komunës apo bashkise. NJQV-të, akoma nuk mund të veprojnë sipas ligjit, që të vazhdojnë me tej për t'i kaluar tek përdoruesit tradicionalë apo persona të tjerë të interesuar. Vetë NJQV-të, nuk kanë pasur dhe duket nuk e kanë edhe tani interesin për këtë proces ligjor të detyrueshëm.

Ky proces vlerësohet si hap tepër i rëndësishëm edhe nga donatorët ndërkombëtarë SNV - SIDA, në kuadër të zbatimit të Projektit “Fuqizimi i Pyjeve Komunalë të Qëndrueshëm Projekt II – Shqipëri”, kanë filluar veprimtari konkrete.

Së pari, të vlerësojë situatën e procesit të regjistrimit të pyjeve e kullotave komunale dhe sistemin respektiv të regjistrimit të pasurive, bazuar në kuadrin ligjor ekzistues dhe përvojën e regjistrimit të tokave bujqësore, duke siguruar rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm dhe për pyjet e kullotat komunale.

Se dyti, të sigurojë mbështetje për 12 komunat pilot dhe aktorët e tjerë në 6 qarqe, për të filluar e finalizuar procesin e regjistrimit si premisë thelbësore për njohjen legale dhe respektimin e të drejtave të përdoruesve realë të këtyre burimeve, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në nivele lokale, duke nxitur interesin e donatorëve potencialë. Për këtë, në 6 qarqe, që mbështeten nga SNV (Kukës, Shkodër, Dibër, Elbasan, Korçë e Gjirokastrë) u zhvilluan seminare me pjesëmarrje të drejtuesve të NJQV, ZRPP, DSHP, Subjekteve private të regjistrimit të PP, etj. Temat e trajtuara në këto seminare ishin: “Baza ligjore e SRPP, hapat e realizuar në procesin e transferimit të pyjeve e kullotave, problematika që rezultojnë. Zbatimi i udhëzuesit për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave në tërësi e në veçanti nga NJQV, për pyjet dhe kullotat në pronësi të tyre. Problematika e evidentuar e përmbledhur është:

- Regjistrimi i pyjeve dhe kullotave në SRPP nga NJQV, por dhe nga Shërbimi Pyjor, është proces thuajse i panjohur dhe aq me pak i zbatuar deri tani. Udhëzuesi “Për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave i vitit 1999 thuajse është i panjohur prej tyre, ky njihet shume pak dhe nga disa ZRPP në rrethe.
- Nuk u evidentua një komunë apo bashki që të ketë futur në SRPP të gjitha sipërfaqet me pyjet apo kullotat e transferuara. U evidentua ndonjë NJQV, që sipërfaqe të kufizuara kryesisht ku janë instaluar antena të telefonisë celulare për efekt kontrate t'i kenë regjistruar (Gjirokastrë; Korçë).
- Me logjistikën dhe burimet njerëzore e financiare që administrohen sot nga NJQV,

del se nuk i kanë mundësitë të përgatisin dokumentacionin e nevojshëm që të kalojnë në sistemin e regjistrimit pasuritë pyjore e kullorore të kaluara në pronësi. Në NJQV nuk kemi të përcaktuar kufijtë e zonave kadastrale (fshatra-ve). Përgatitja e hartave treguese paraqet vështirësi teknike.

- Të dhënat për ngastrat pyjore të transferuara në pronësi/përdorim të komunave nuk janë reale, ato ndryshojnë shumë me gjendjen në terren. Ka pasaktësi në sipërfaqe, destinacion, strukturë, etj., pra formularët që paraqesin ngastrat e transferuara (ato janë marrë nga planet e inventarizimeve apo mbarështimit të vitit 1985) nuk paraqesin gjendjen e tanishme, çka tregon se vetë kadastra pyjore e kullorore ka pasaktësi të theksuara.
- Nga pjesëmarrës në seminare, kryetarë apo përfaqësues të komunave, pretendojnë se procesi i transferimit të pyjeve e kullotave kërkon rishikim, duke bërë kryesisht shtim të sipërfaqeve të transferuara. Komunitat, në të shumtën e rasteve kanë pranuar çfarë u ka ofruar Shërbimi Pyjor, pa ditur se ku shtrihet ai fond pyjor apo kulloror që u është transferuar.
- Mungesa e kufijve administrativë të materializuar në terren e të digjitalizuar në harta, përbën një problem të madh për të gjitha NJQV. Në qarqun e Kukës, ka shumë komuna që kanë mjaft ku-

fij të panjohur që kishin njësitë administrative para viteve '90 dhe kjo pengon përcaktimin e saktë të tyre.

- Ndonëse është detyrim ligjor, regjistrimi i pasurive të paluajtshme nga poseduesi, përfshi dhe pyjet e kullotat komunale, vihet re se deri tani nuk ka motive apo interesa të qarta nga drejtuesit e NJQV-ve, që të ndërmarrin nisma bashkëpunimi, të aplikojnë apo dhe të gjejnë donatore, që të fillojnë regjistrimin. Ka përvojë e bashkëpunim midis qeverisjes vendore me ZRRPP, kur u krye apo dhe vazhdon të kryhet regjistrimi fillestar i tokës bujqësore dhe banesave.
- Në shumë NJQV, mungesa e personelit pyjor të kualifikuar, për administrimin për zbatimin e planit të menaxhimit të pyjeve e kullotave komunal në tërësi bën, që jo vetëm regjistrimi i pyjeve dhe kullotave të mos realizohet, por dhe menaxhimi i tyre të vihet në pikëpyetje.

Njësitë e Qeverisjes Vendore me Zyra Qendrore dhe ato vendore të regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Shërbimi Pyjor në qendër dhe në DSHP, janë aktorët kryesorë, bashkëveprimi midis tyre është domosdoshmëri, që dhe regjistrimi pyjeve e kullotave të behet sipas ligjit.



Vijon nga fq. 3

“Bjeshkët e Namuna”

shkallës së parë. Këtu lejohen kërkimet shkencore, veprimtari ekoturistike të lira dhe kullotja sezonale e bagëtive. Zona e dytë e përdorimit tradicional përfshin 49.604 ha ose rreth 90 % dhe përfshin tokat bujqësore, pyjet e kullotat, ku lejohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale, si bujqësi, pyje, kullota, grumbullim i bimëve mjekësore e aromatike, me përdorim të balancuar të tyre. Nuk lejohen ndërtime dhe veprimtari që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit. Ndërsa në zonën e tretë, të zhvillimit të qëndrueshëm, hyjnë 1572 ha, ose rreth 2 %, ku përfshihen hapësirat



urbane, toka bujqësore e pyjore pranë vendbanimeve, etj.

Pra, siç del nga ky shembull, këto zona nuk i kufizojnë aktivitetet e pronarëve. Madje, kur të marrim parasysh faktin se në Kosovë, në lartësitë e mëdha të Bjeshkëve, pothuaj të gjitha pronat janë publike, atëherë mund të thuhet se kufizime për përdorimin e tyre nga pronarët, nuk do të ketë.

Me shpalljen e kësaj hapësire Park Kombëtar, duhet t'i bëhet me dije popullsisë së Rugovës e Pejës se zërat që janë përhapur atje se, çdo gjë do t'u ndalohet, nuk janë të vërteta. Vetëm shkatërrimi barbar ilegal i pyjeve do të ndalohet! Prandaj, pikërisht tashti, ekspertët nuk duhet të heshtin, por zëshëm ta thonë

fjalën e tyre dhe të kenë qasje profesionale. Komunikimi me këta njerëz dhe grupet tjera të interesit, duhet të jetë i hapur e pa sherre, sepse kjo është një sfidë, për t'i shërbyer kombit dhe brezave që do të vijnë pas nesh. Nëse ar-


syjeja dhe dija do të mbizotërojnë në këtë proces, atëherë të gjithë ne, padyshim, jemi në rrugën e duhur.

Përkundrazi, me këtë ligj, do të ofrohet edhe një mundësi e madhe, ajo e ndërprerjes së shkatërrimit mizor të pyjeve, e cila po vazhdon për disa vite në Deçan,



Pejë, Istog e gjetiu. Ka disa vite që në këto anë është hapur debati për ndalimin e kësaj katastrofe. Madje, janë përdorur edhe mjete të sofistikuara të vrojtimit e infrastrukturës. Por ato nuk kanë dhënë sukses!

Suksesi do të arrihet kur të fillojë zbatimi i këtij Ligji (pas miratimit të tij) dhe mbështetjes së nevojshme që Qeveria do t'u japë pronarëve në këto zona.



(Hartina, pseudotsuga, larshet dhe pisha e zezë "gjunjëzohen" nga furtuna në Studenicë ...
dëme të dukshme në fidanishten e Pejës)

Në Komunën e Istogut

Inxh. MIFTAR LOKAJ
SNV, Kosovë

Erërat e fuqishme - fatale për pyllin eksperimental



e ato pyjore të kësaj komune. Kulturat pyjore eksperimentale në fshatin Studenicë me sipërfaqe rreth 30 hektarë janë dëmtuar në mbi 90 % të tyre, çka mund të shihet edhe në fotografitë e marra me datën 11 janar 2012.

Menjëherë pas njoftimit për atë çka ndodhi në objekt, filluan të evidentohen e vlerësohen dëmet e shkaktuara, nga ekupe profesionale të Agjencionit Pyjor të Kosovës – zyra koordinuese në Pejë në bashkëpunim me njësinë komunale pyjore në Istog.

Kur u ndodhën në objekt për këtë qëllim, ndodhej edhe drejtori i zyrës koordinuese të APK në Pejë, Ibish Blakaj, i cili u shpreh se as në dokumentacionin e zyrës që drejton dhe as nga bisedat me komunitetin e punëtorë të moshuar, nuk mbahet mend një erë me intensitet aq të madh dhe kaq dëmprurëse. Një ditë me herët këtë objekt e kishte vizituar



Ndoshta natyra po kryente ritualet e saj të vazhdueshme ciklike. Ose "i kishte mbetur hatri" pasi njeriu kishte futur lloje të huaja në atë territor, pa u konsultuar me veçoritë e natyrës dhe çfarë ajo pranon ta rrisë e ta pranojë dhe çfarë kundërshton e kërkon të kthehet në gjendjen e mëparshme ... Natën, ndërmjet datës 7 e 8 janar 2012, Rrafshi i Dukagjinit u përfshi nga erëra të fuqishme, por dëmet më të mëdha i pësoi komuna e Istogut. Sipas Januz Zeqiraj, banor i fshatit Studenicë, ky rajon gjithnjë ka qenë i atakuar nga erërat e fuqishme edhe pse vitet e fundit me intensitet më të vogël e më të rralla, por "era që fry natën ndërmjet së shtunës e të dielës, nuk mbahet mend as nga më të moshuarit e fshatit". Përveç dëmeve në objekte banimi, në shkolla e ndërtesa të institucioneve, dëme shumë të mëdha pësuan edhe sipërfaqet bujqësore



edhe ekipi profesional i Institutit të Pyjeve në Pejë.

Historikisht, sipërfaqja ku ka qenë ngritur ky eksperiment, u ka takuar familjeve Sadikaj, Gashi, Ramqaj, Maxharaj e Zeqiraj, të cilët deri në atë kohë e kishin shfrytëzuar për kultivimin e drithërave dhe vreshtave. Për shkak të tatimeve shumë të larta, të caktuara nga pushteti i kohës, fshatarëve që nuk kanë pasur mundësi të paguajnë tatimet u është konfiskuar toka. Kultura eksperimentale pyjore në fshatin Studenicë është ngritur në fund të viteve '50-fillimi i viteve '60 të shekullit të kaluar. Qëllimi i ngritjes ka qenë hulumtues - shkencor. Në të janë mbjellë: hartinë, pseudotsugë, larsh, larsh evropian dhe pishë e zezë. Instituti i pyjeve në Pejë është marrë me monitorimin e zhvillimit të kësaj kulture pyjore deri në momentin e rrënimit të institucioneve të Kosovës. Më pas, me mena-

xhimin e objektit është marrë Agjencioni i pyjeve të Kosovës. Kjo kulture pyjore është në kuadër të njësisë menaxhuese "Lugu i Butë", përkatësisht ngastra pyjore nr. 21, e cila para shkaktimit të dëmeve nga era kishte 332 m³/ha masë drunore. Priten vlerësimet pas evidentimit të dëmeve nga ekipet profesionale të APK, zyra koordinuese në Pejë dhe Instituti Pyjor në Pejë.

Pasoja të ngjashme ka pësuar edhe fidanishtja e Institutit të Pyjeve në Pejë, e cila gjendet në lokacionin e fshatit Orrobede të Istogut, ku janë evidentuar 64 trunje të thyer, kurse dëme më të mëdha kanë pësuar mbulesat e serrave për prodhimin e fidanëve. Edhe këtu komisionet profesionale janë në evidentim dhe vlerësim të dëmeve.



Koment i Bordit të FKPKK

Vijon nga fq. 1

pasuri. Tashmë është forcuar bindja se transferimi i përgjegjësisë për mbarëshkrimin e pyjeve dhe kullotave nga NJQV, dhe më tej tek përdoruesit tradicionalë, mbështetur në të drejtën e traditën zakonore të hershme, është mjaft dobiprurës e i suksesshëm, prej të cilit përfitojnë familjet bujqësore, që përbëjnë gjysmën e popullsisë së vendit, si dhe shoqëria në tërësi.

Nga diskutimet e ballafaqimet e deritanishme me keqardhje vërejmë se nga administrata shtetërore ka



hezitim, që vjen si nga frika mos dëmtohet pylli nëse shkon tek i zoti, ashtu edhe nga paqartësitë për zhvillimin e reformave, pa përmendur ndonjë hezitim tjetër ... Por, përvoja tregon se lëvizja e hallkave të shtetit për të dërguar pyllin tek i zoti, i cili ta marrë në mbrojtje, është investimi më i madh që mund të bëhet nëse duam

që vërtet pylli të mos humbasë mundësinë e ripërtëritjes.

Bazuar në përvojat e traditat shekullore, mendojmë se mbi 60 % e territorit të pyjeve duhet të kalojnë në pronësi të përdoruesve tradicionalë, ndërsa mbi 30 % duhet t'u kalojnë NJQV. Kjo bazuar në analizën e rritjes vjetore dhe nevojat e banorëve për dru zjarri e produkte të tjera, si dhe për mbjelljen e territorit me drurë pyjorë e frutorë në të gjithë territorin, përfshi dhe tokat boshe. Ndërsa një sipërfaqe prej rreth 10 % të mbetet në pronësi të Shërbimit Pyjor, i cili duhet të sigurojë modelin e menaxhimit për zonat me rendësi të veçantë për biodiversitetin në Shqipëri.

sore, si dhe u publikua deklarata e Tiranës për reformën e tokës.

Federata Kombëtare përgëzon qeverinë shqiptare për mundësinë e thellimit të reformave për privatizimin e pyjeve në Shqipëri. Fjala e kryeministrit "Pyjet do t'i bëjmë me Zot", është mundësia më e mirë, se në fakt ata janë zot në pronën e tyre, por qeverisjet e gabuara ndër shekuj i kanë lënë pa zot.

Në këtë proces kemi pasur e kemi edhe mbështetjen e Bankës Botërore, Qeverisë Suedeze, Federatës Evropiane të Pyjeve, SNV, Koalicionit Ndërkombëtar të Tokës, SOROS-it, ILC-së, etj.

Pylli malor, "specie" në rrezik zhdukjeje

Toka është djepi i jetës dhe shtëpia e përbashkët e njerëzimit. Një vëzhgim i kohëve të fundit dëshmon se nga mbi 4.6 milion vjet të evolucionit të jetës në tokë, afërsisht 10 mijë vjet i janë përkushtuar erës së bujqësisë dhe vetëm 200 vjet janë të revolucionit industrial. Kjo rrjedhë e gjatë ka krijuar shoqërinë e civilizuar, që synon emancipim e zhvillim, shpesh duke e harruar e bërë gabime feminare me nënën natyrë, me tokën e malit, pyllit e kullotës, ujin e ajrin që ushqejnë jetën. Shoqëria krenohet me malet, që krahas fushave e deteve janë pasuri e begati për vendet ku ndodhen. Konsideruar prej shumicës si shtëpi e perëndive dhe strehë e paraardhësve, malet kanë kuptim të veçantë shpirtëror për shumicën e kulturave dhe besimeve fetare në botë. Shkencëtarët i quajnë "kulla të ujit", pasi malet mbajnë në gjirin e tyre më shumë se gjysmën e rezervave të ujit të pijshëm të planetit. Ata janë edhe djepi i biodiversitetit, duke mbajtur mijëra specie endemike. Tek ne malet mbajnë edhe floririn e gjelbër, pyjet dhe kullotat, pasurinë e falur nga Zoti, me të cilën para-

ardhësit krijuan hap pas hapi shoqërinë njerëzore. Shfrytëzimi i vazhdueshëm e ka lodhur e shkatërruar mëmën tokë e veçanërisht krijesën më të brishtë e krenare të saj, malin. Pyjet e maleve na japin për çdo vit, nëpërmjet druve të zjarrit, energjinë që na duhet për të ngrohur shtëpitë e për të gatuar, pjekin gurin gëlqeror, por na japin edhe qymyrin e drurit që së shumti malësoret e jugut e eksportojnë. Në total pyjeve të maleve u marrim mbi 2 milionë metër kub material drusor në vit, rreth tre herë më shumë se ata mund të na japin dhe në regjistrat e shtetit shkruhen rreth 200 mijë metër kub, pjesa tjetër ka vite e vite që nuk regjistrohet, duke u trajtuar si asistencë për nevojat e popullatës. Pra, pyllit të malit i marrim në mënyrë informale mbi 50 milionë dollarë prodhim, produkt dhe punësim, që nuk merret në konsideratë në të ardhurat kombëtare. Pylli dhe kullota e malit mbajnë mbi tre milionë krerë të imëta, përsëri pothuaj në mënyrë informate, që marrin për çdo ditë rreth 18 milionë kg biomasë. Pra, mali po

Ti bëjmë pyjet me Zot, rruga e vetme për të mbrojtur pyjet

Vijon nga fq. 1

krijuar Federata Kombëtare, që ka rol koordinues e këshillues për të gjitha nivelet e strukturat në pyjet komunale.

Vetëm gjatë viteve 2003-2011, bazuar në përvojën e fituar dhe nevojat e mbi 50 000 njerëzve (përfshi komunitetet e fshatrave, shoqatat, komunat dhe komunitetet rurale) në 10 qarqe janë bërë pesë rezoluta e u janë paraqitur niveleve të vendimmarrjes për zhvillimin e reformave për pronat dhe për-

mirësimin e akteve ligjore, bazuar në Kushtetutë e në Konventa të ratifikuara dhe nevojën për t'u integruar në BE.

Në vitin 2011, me mbështetjen e qeverisë shqiptare, të Kryeministrit Berisha, ministrit të Mjedisit, Mediu dhe atij të Bujqësisë Ruli, u organizua Konferenca Ndërkombëtare e tokës, me pjesëmarrjen e 40 shteteve. Në këtë kuadër, u përgatit dhe një memo për mundësinë e zhvillimit të reformës për tokën pyjore e kullo-

Vijon në fq. 7

Haki KOLA

Nëse dikush do të bëjë dru në Turqi (ish-vend i perandorisë Osmane), atëherë ai shkon në pyllin më të afërm për të bërë dru. Ligji turk i vitit 1899 për pyjet, i cili sigurisht nga ana teorike ishte shumë i mirë, kishte për pasojë një shkretim total pyjesh.

Kujtime nga jeta e Franc Baron Nopca në librin "Udhëtime nëpër Ballkan"

Kambanat, sikur mbytemi nga uji, thahemi nga mungesa e tij, digjemi apo s'kemi të ngrohemi, bien për të ndryshuar politikat për tokën pyjore e kullosore. Këto politika kanë rol shumë të madh në përmirësimin apo degradimin e tokës, në veshjen apo zhveshjen e saj, në një regjim ujor normal apo jonormal. Në kohë përmbytjesh, thatësirash apo djegiesh, duket sikur qeveria e hap njërin sy dhe hedh ndonjë fjalë, që pyjeve do t'u gjejnë të zotin. Disa këshilltarë këtë e pasojnë tek Ministrat; një mbledhje e vagëlluar bëhet me teknikienë apo burokratë, duke e pasuar direktivën. Këta të fundit, tashmë të mësuar për të kaluar lumin, dinë se si ta trembin shefin se kjo është gabim apo të komplikojnë, vonojnë aktin e duhur juridik, deri sa një prioritet tjetër del, harresa kapllon, shkatërrimi vazhdon e duhet një tjetër vaki, që qeveria prapë të shprehet, një cikël, kusuret e të cilit i paguan toka, që pakësohet, shkretohet dhe varfëria jonë që shtohet.

Si në kohën e Turqisë edhe sot në kohët moderne, rreziku më i madh, që po e kërcënon deri në humbje totale jo vetëm pyllin, po edhe vetë tokën, është mungesa e të kuptuarit dhe të vlerësuarit të problemit e harmonisë së njeriut me tokën e ligjërimit të këtyre raporteve. Zyrtarët e ftohtë urbanë, skllëvër të sloganeve fikse, krijojnë konfuzion në të gjitha shtresat e shoqërisë, fusin në konflikt popullsinë urbane me atë rurale. Shumica e të shkolluarve, pavarësisht nga specialiteti i ngushtë, janë të mbyllur në sloganin: mbron pyllin, duke luajtur patriotin e krijuar një ç'orientim të madh në gjithë shtresat shoqërore e veçanërisht tek vendimmarrësit.

Shpesh trajtimi apo, shqip, prerja tradicionale e pyllit të vogël afër shtëpisë, megjithë rezistencën që ka bërë gjithë kohëve, duke u trajtuar, pakësuar e shtuar, nga të shkolluarit trajtohet si një kasaphanë. Shumë shtresa shoqërore, duke përfshirë këtu edhe gjithë mediat, e perceptojnë pyllin si një vlerë muzeale, që në një farë mënyre duhet të rrije diku, pa u prekur. Nëse ka interes për ta shpëtuar këtë pasuri kombëtare, hapi i parë është të zgjidhet jo vetëm problemi i pronësisë. Pyjet e vogla rreth tokave bujqësore, me prejardhje nga lashtësia, kanë qenë e janë pronësi e atyre banoreve, e prita e parë për të ruajtur pyllin natyral malor. Por ne duhet që të shkojmë më tutje, të kuptojmë se si banorët i vlerësojnë këto pasuri, dhe si i kuptojnë këto pasuri - një gjë është e sigurt - pyjet përreth shtëpive apo fshatrave kanë mbijetuar deri

Degradimi i tokës dhe politikat aktuale të pronësisë

sot jo, kurrën e kurrës, për meritën e shtetit, po për faktin se ata i kanë dhënë vlerë popullit që i ka mbajtur dhe deri në vitet '80 të shekullit të kaluar, kur u bë tufëzimi, kanë qenë mbrojtësi më i mirë i pyllit natyror malor. Pylli malor nuk përdorej për dru për ngrohje, ai kontribuonte thjesht për ndërtime e pak drurë të tharë, ndërsa pylli i vogël mbante shtëpinë të ngrohur, blegtorinë të ushqyer, peizazhin të zbukuruar e mbrojtur.

Ndoshta duket si paradoks, për njerëzit urbanë të institucioneve shtetërore e të medias, por faktet dëshmojnë se anëmbanë vendit ka njerëz që i duan pyjet, që i veshën me drurë pas vitit 1990 anët e lumenjve, përrrenjve e kanaleve, me njohuritë që kanë përfutur nga puna e jeta e përditshme në natyrë, shpesh me një zgjuarsia që kurrë nuk është vlerësuar sa duhet nga ekspertët, shpesh me origjinë nga të njëjtat vende, por me ritëm të ndryshëm të jetës e emocioneve.

Shpesh abuzohet me përdorimin, duke e cilësuar si shkatërrim. Që të inkurajojmë përdorimin duhet të shmangen gabimet që thellojnë konfliktet, veçanërisht kur trajtohet e përbashkëta, që pjell herë pas herë tragjedi. Kur thuhet ndalohej me të drejtë përjashtohen vendet me rrezik erozioni, lloje të rralla. Nëse lejohet përdorimi, gjykimi ku ndodhet, rrethanat apo cili ka qenë efekti i trajtimit, sqarohet kush është pronari aktual, tradita e përdorimit, detyra të cilat po përcillet t'i marrë përsipër shërbimi në ngritje e sipër i këshillimit pyjor.

Në shkurret mesdhetare të Shqipërisë së mesme e perëndimore, mund të punësohen qindra banorë, për të bërë rrallime e për të mundësuar përmirësimin e llojeve, cilësinë e shpejtësinë e rritjes. Kuadri ligjor bëhet pengesë për të dhe u hapet rrugë prerjeve të fshehta e prodhimit ilegal të drurit e qymyrit. Pronari do të ishte një kujdestar model dhe ritmet e kthimit në pyll të këtyre shkurreve do ishin më të larta.

Konservimi apo ruajtja përbëjnë një stad të harmonisë së njeriut me tokën. Njeriu në pronën e tij në të shumtën e rasteve e ka dëshmuar këtë harmoni. Kur përmendet toka sigurisht që nënkuptojmë të gjithë përbërësit mbi e nën të. Harmonia me tokën është si harmonia në familje, si harmonia njerëzore. Banorët lokalë janë pritësit e përcjellësit e shpendëve vendore e atyre shtegtarë, shtëpitë e drurët e tyre janë streha e përvitshme e këtyre banoreve. Këta i mbajnë pasi i duan, ashtu siç kurrë nuk kanë tentuar të zhdukin as edhe grabitqarët e tyre. Ata e dinë më mirë se gjithkush se nuk mund të duash ujin e të lësh pasdore kullotën, nuk mund të mbjellësh pyllin e minosh arën e misrit. Toka është një organizëm. Pjesët e saj, ashtu si gjymtyrët tona, konkurrojnë me njëra-tjetrën. Kjo konkurrencë është më tepër një punë brenda për brenda se sa kooperim. Kur ndërhyr pa takt në këto relacione, të harmonisë së njeriut me natyrën, pa e njohur në thellësi, më tepër shkatërron se sa ndërton çfarë dëshmon stadi aktual i tokës sonë pa pronar.

* *

Fan Noli tentoi të bëjë këtë pajtim me anë të programit të vitit 1924, duke projektuar reformën, që kishin bërë rreth 120 vjet më parë evropianët, duke bërë ndoshta për herë të parë e të fundit deri sot, si pjesë të programit të qeverisë, ndarjen popullatës të asaj pjese pylli që i mjaftonte për të plotësuar nevojat për ngrohje, ndërtim e kullotje, duke e bërë popullin kujdestar të tokës e mirëmbajtës të saj, ndërsa pjesën që tepronte, që ishte mbi nevojat bazë të popullit, ta administronte shteti. Dukej si vazhdimësi e natyrshme e asaj që kishte dalë në Evropë nga revolucionet popullore të vitit 1848, ku populli me qeveritë ranë dakord për shpërndarjen e hapësirave pyjore e kullosore mbi bazë fshati, grupi shtëpish e familjesh, sipas pranisë, relievit e traditave për sigurimin e nevojave të banoreve. Ndoshta prania e Turqisë në Ballkan e pengoi apo mënjanoi këtë reformë tepër jetike për tokën, e duket se pak nga vendet e Ballkanit perëndimor, avancuan duke e shpërndarë këtë të drejtë ndoshta edhe pjesërisht në fshatra e familje, pasi vetë perandoria Otomane, zbatonte një regjim juridik tepër të koklavitur për tokën.

Pas luftës së Dytë Botërore, këto vende u rreshtuan në anën e tyre që çdo gjë e kishte monopol shteti dhe kur, të gjithë bënin sikur ngopeshin e u tepronte, mentalitet që vazhdon shpesh sot e kësaj dite ...

Ish-kryeministri shqiptar i viteve '80 të shekullit të kaluar vizitoi një repart ushtarak, diku në Shqipërinë Lindore e, krahas të tjerave, i pyeti ushtarët nëse e kishin të mjaftueshëm ushqimin. Ushtarët, siç ishin në rresht, u përgjigjën si në kor, se ushqimi u delte e u tepronte. Po, çfarë e bëni atë që tepëron, vazhdoi ai? Dhe ata sërish në kor, iu përgjigjën se e hanin të tërë.

Kjo më kujtohet sa herë debatojmë për pylltarinë dhe rrymat që përkrahin përqsjen e pylltarisë në shkallë të vogël (në dukje e parëndësishme) që plotëson

nevojat e komunitetit për ngrohje (bio-energji), bazë ushqimore për blegtorinë, ruajtjen e tokës, strehim gjahu, etj., janë gjithmonë në debat përballë përqsjes për pyjet industriale me destinacion plotësimin e nevojave të industrisë si të mobileve, letrës, ndërtimit etj., që është këmbëkryq në vendet ballkanike, që nga mësimdhënësit e deri tek politikbërësit. Kjo për faktin se njerëzit e qendrave urbane, pavarësisht origjinës se tyre, që janë njëkohësisht përfaqësues të enteve planifikuese, apo edukative, janë të prirur, që pyllin ta kategorizojnë si pasuri kombëtare, që fshatarët nuk i kanë dijet e duhura për ta menaxhuar, prandaj ndërtojnë edhe politika menaxhuese pikërisht sipas kësaj përqsjeje. Kjo krijon konflikt gjate zbatimit, pasi shihet se ashtu, heshturazi, banorët e pakësojnë volumin e këtij burimi, i ndërrojnë pamjen e formën, duke krijuar herë pas here konflikte. Përgjithësisht këta të dytë nevojat e komunitetit i konsiderojnë përgjithësisht të vogla, që mund të zgjidhen psh, ashtu siç propozohet të zgjidheshin nevojat për qumësht e mish nga 'tufëzat', pasi kishin dështuar tufat e mëdha të fermave shtetërore, për të furnizuar qoftë edhe kopshtet e fëmijëve me qumësht.

Megjithëse pylli ballkanik është tepër i fragmentizuar, pjesë e relievit dhe e peizazhit, historikisht si politikat pyjore edhe vetë shkollat pyjore e kane larguar vëmendjen nga pylli me përmasa të vogla apo nga produktet për nevojat bazike të popullsisë, ngrohje e gatim dhe duke u shmangur nga sistemet e menaxhimit dhe kontrollit lokal të pyllit, si edukimi ashtu edhe politikat janë orientuar drejt regjimeve të menaxhimit në përmasa të mëdha të orientuara nga tregu, ku kontrolli u është deleguar autoriteteve të qeverisë qendrore, të përqendruar në zonat urbane.

Kjo politikë e gabuar e pronësisë mbi tokën, nënvleftësimi i nevojave dhe planifikimi jo realist i tyre, kombinuar me prapambetjen ekonomike e sociale, si dhe ndjeshmërinë tepër të madhe të sistemeve të brishta ekologjike, veçanërisht pjerrësia e ekstremet klimatike, janë ndër shkaktaret e këtij degradimit intensiv në pyje. Një pjesë e faktorëve, veçanërisht pronësia e edukimi është në duar të shoqërisë. Shoqëria e ka përgjegjësi ruajtjen e tokës për brezat që do vijnë pas nesh të jetojnë në tokën tonë.



Përsëri për arrën

Prof. As. Dr. Ahmet OSJA

Dedaj (M. Madhe) Kodër Arrë, në Seman Fier Arrishtë, në Tropojë Guri i Arrës, në Fan Mirditë Guri i Arrës, në Shkodër Arra e madhe, etj.

Arra është një nga drufrutoret që jeton 250-350 vjet e më shumë. Mund të rritet në lartësi deri 25 – 35 m. Nuk ka asnjë pjesë të kësaj bime që nuk shfrytëzohet sëpaku për një gjë të vlefshme. Prodhimi kryesor dhe qëllimi i parë i kultivimit janë frutat, të cilat përdoren për ngrënie si në kushte të zakonshme edhe si pjesë e dietave të caktuara. Fëmijëve shëndetligj mund t'u jepjen nga moshë 3 - 7 vjeçare, nga 2-3 kokrra arra në ditë. Po ashtu, në rritjen apo siç quhet, majmjen e gjelit të detit përdoret nga një kokërr arrë në ditë (shpesh u futen me zor në gojë, kokrra jo shumë të mëdha), për një periudhë prej 40 ditësh. Fruti i arrës përdoret gjithashtu në industrinë e ëmbëlsirave, gjerësisht në pasticeri, në prodhimin e pijeve të ndryshme, për prodhimin e vajit, etj. Thelbi i arrës (pjesa e ngrënshme) është i pasur me proteina, karbohidrate, vaj, lëndë mineralë, etj. Vlera energjetike për trupin e njeriut që merret nga 1 kg thelpinj arrash, është 6-8 herë më e lartë se 1 kg mish gjedhi.

Mbulesa e kokrrës së arrës përdoret për nxjerrjen e bojërave, ndërkohë që druri përdoret në prodhimin e mobileve me vlera të larta. Ato janë shumë të kërkuara si në tregun e brendshëm edhe në atë të jashtëm. Të përdorshme

janë edhe gjethet e arrës, si në industrinë e bojës, ashtu edhe për nxjerrjen e esencave të ndryshme.

Arra i ofron fermerit një mundësi më shumë për t'u marrë me një kulturë alternative, e cila mund të mbillet në tokat e pazëna me bimë bujqësore, që mund të sjellin fitim mjaft të mirë për ekonominë e tyre. Nga ana tjetër, kultivimi i arrës ndikon në mbrojtjen e tokës nga erozioni, krijon peizazh të përmirësuar, duke ndikuar sadopak në zhvillimin e turizmit në zonat ku kultivohet.

Në një dynym mund të mbillen rreth 65 rrënjë arra. Pas 8 - 10 vjetësh (fidanët e prodhuar në vend) dhe pas 3 - 5 vjetësh (fidanët e importuar), hyjnë në prodhim. Mund të arrijë të prodhojë 15 - 22 kv/dy. Për këtë arsye, arrës së kultivuar duhet t'i kryhen disa shërbime si: punimi i tokës, plehërimi, ujtitja, etj. Ndërsa krasitja e arrës kërkon shumë kujdes dhe në kushte normale është mirë që të mos kryhet nga kultivues që nuk e njohin mirë biologjinë e kësaj kulture. Vetë bima e arrës është mjaft rezistente ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Në kushtet e vendit tonë, prodhimi i arrës është plotësisht organik. Meqë fruti i arrës është mjaft i kërkuar në treg, kjo përbën një mundësi shumë të mirë për fermerët për të fituar.

Fruti i arrës, kur është i tharë në parametrat e nevojshëm, ruhet lehtë për periudha relativisht të gjata.

Vendi ynë njihet si një nga vendet ku bima e arrës rritet që nga ultësirat bregdetare e deri në lartësitë mbi 1200 m. Po ashtu, arra kultivohet në ultësira, në brigjet e lumenjve, përrrenjve e deri në cepat e pronave, përreth tokës së punuar.

Janë disa zona që njihen për kultivimin e arrës, si: Zagorë në malësinë e Madhe që në vitet '40 të shekullit të 20-të, kishte mbi 6000 rrënjë arra, fshatrat Lotaj e Abat në Dukagjin, disa fshatra të Tropojës, Gramshit, Peshkopisë, Matit, Librazhdit, Skraparit, Kolonjës, Devollit, etj.

Sot, përveç shtatë specieve të kultivuara të arrës, në fshatin Val të Martaneshit, gjendet edhe arra e egër, një pasuri mjaft e çmuar për koleksionet, si dhe për punën kërkimore-shkencore.

Në vitet '70 të shekullit të 20-të, në rrethin e Dibrës, filloi një punë e mirëfilltë shkencore; në fshatin Maqellarë të këtij rrethi u ngrit një fidanishte, ku u prodhuan disa mijëra fidanë nga disa kultivarë arrash të mara në rrethe të ndryshme të vendit, si: Tropojë, Has, Librazhd, Gramsh, Skrapar, Mat, etj. Me këto materiale filloi puna seleksionuese dhe tipizimi i

kultivarëve, ku më vonë u arrit të mbillen disa dhjetëra hektarë të fshatrave të ndryshme të Peshkopisë.

Të dhënat tregojnë se që nga vitet '80 të shekullit të 19-të, në vendin tonë filloi të shfaqet interesimi për të blerë drurin e arrës. Duke filluar që nga këto vite e më pas, u prenë disa dhjetëra mijëra trungje (rrënjë) në luginat e Fanit, Matit e Shkumbinit. Vetëm me 20 nëntor të vitit 1934, nga dogana e Shkodrës u transportuan 27.484 trupa arre për në Itali dhe rreth 5360 kilogram fruta arre për në Greqi, që kapnin vlerën prej 11.000 franga ari. Prerja pa kriter e kësaj bime vazhdon të ndodhë edhe në ditët tona.

Ka ardhur koha, kur fermerët, shoqatat e përdorimit të pyjeve e kullotave (SHPKK), por edhe vetë shteti, duhet të nxisin e të mbështesin fermerët për kultivimin e kësaj kulture, duke aplikuar me projekte, të cilat të marrin përsipër jo vetëm shtimin, por edhe përmirësimin e teknologjisë së kultivimit dhe shtimin e prodhimit të marrë për njësi të sipërfaqes.

Klima, toka dhe tradita janë të admirueshme dhe mjaft premtuese për kultivimin në shkallë të gjerë të kësaj kulture. Por, për të pasur sukses në këtë sipërmarrje kërkohet edhe dëshirë, kualifikim e mbështetje, për të arritur si fazë e parë në numrin e rrënjëve që kishim rreth 100 vjet më parë, e më pas, shtimin gradual deri në dyfishimin e këtij numri.

NJOFTIM

Fidanishtja e Kurtish Dafkut në Komunën Topojan të Kukësit, disponon fidanë: 1. Mështekne (dyvjeçarë) copë 30 000

2. Pishe (dyvjeçarë) copë 10 000

Kontakti: Kurtish DAFKU cel: 068 62 75 433; 067 20 37 565



Në kuadër të synimeve madhore të qeverisë shqiptare për zhvillimin e bimëve arnore, gazeta jonë përpiket te sjellë sa më shumë informacion për këto kultura, aq më tepër që rrallë gjen botime të kësaj natyre. Vërtetë këto kultura njihen që nga lashtësia, po si në çdo fushë, shkenca ndërhyr me ritme të shpejta, përvoja bën të vetë, sjell të reja. Në këtë vështrim, po sjellim një informacion të shkurtër për arrën kryesisht në vendin tonë.

Arra (*Juglans regia* L.) në vendin tonë takohet si bimë e kultivuar, por edhe në gjendje natyrale. Janë të njohura disa krahina ku historikisht është rritur arra. Vendet më tipike janë ato të luginave të lumenjve si: lugina e Cemit, Shalës, Irit, Drinit, Valbonës, Fanit, Matit, Shkumbinit, Osunit, Devollit, Vjosës, Lumit të Vlorës, etj. Klima dhe toka e kanë favorizuar rritjen dhe shumëzimin e kësaj bime. Kështu, sot gjenden dhjetëra toponime që janë të lidhura me arrën: në Peshkopi gjendet fshati Arras, në Sollak Kisharë, në Pukë Fushë-Arrëz, në Zadrimë Arrnjet, në Kolonjë Rehovë, në

Vijon nga fq. 5 Pylli malor

“specie” në rrezik zhdukjeje

zhvishet e shkretohet dhe hallet shtohen. Por, megjithë këto pasuri natyrore e kontribut, komunitetet malore, “malokët”, janë më të varfrit e hallet më të shkurtra. Për të mbijetuar nga viti në vit ata rrisin shfrytëzimin e pasurive të natyrës në male e lugina. Përdorimi i pakujdesshëm i pyllit e kullotës së malit ndikon në një pjesë shumë më të madhe të tokës se sa vetë malet. Nga mënyra e trajtimit të ekosistemeve malore mund të pasurohen apo varfërohen më shumë se gjysma e shqiptarëve. Literatura dëshmon se i njëjti raport është për gjithë popullsinë e globit.

Pas mijëra vitesh përshtatjeje të njerëzimit me jetën në male dhe pajtimit me ta, gjysmëshekulli i fundit na bën dëshmitarë të ndryshimeve të çmendura. Popullsia shqiptare u trefishua dhe bazën e jetesës ia kërkonte përsëri malit. Ëndrra për zhvillim të shpejtë të industrisë e infrastrukturës bënë që pylli shqiptar t'i nënshtrohej i tëri një ndryshimi shumë të shpejtë. Një pyll i përdorur pothuaj vetëm për kullotë e ngrohje nga një popullsi e

vogël e me pak kërkesa deri në luftën e dytë botërore, u përshkrua pothuaj i tëri me prerje, që nga rrëpirat e deri në perla të veçanta, të cilave gradualisht po u humbasim edhe fotografitë. Bukuri mahnitëse të natyrës si Liqenet e Lurës, Balgjait apo Liqenet e Zerqan-Bulqizës, me vlera biodiversiteti të njohura botërisht, u mbuluan me rrugë auto dhe u vendosën në zhurmën shurdhuese të motosharrave. Kjo i gjeti malësorët nën komandën e shtetit të centralizuar dhe nuk i lejoi që të bënin përshtatje me kushtet e reja. Futja në ekonominë e tregut në 15 vjeçarim e fundit, si dhe kontaktet me një botë shumë të zhvilluar konsumi, si dhe të ekonomisë, si të thuash, me lekë në dorë, kundrejt asaj në natyrë, që historikisht i ka dominuar malësorët, bëri që malësorët e Lurës, Pukës, Mirditës, Krujës, Kukësit e Bulqizës, të mashtruar nga një treg i pabesë, të fillonin një garë të ethshme, për të gjetur sa më shumë para, duke i ofruar tregut të pangopur perla të tilla të rralla për Evropën siç ishte druri i

Amenit, të cilit tashme mund t'i gjejmë vetëm filiza që po përpiqen të zënë vendin e prindërve të tyre mbi 40 m të lartë. Bashkë me të edhe shumë drurë të tjerë pyjorë me vlera të jashtëzakonshme. Nuk mund të rrimë pa përmendur edhe 20 ha e vetëm me drurin e dafinës (e vetmja dafinë natyrore në Shqipëri, konsideruar nga grekët e lashtë si druri i lavdisë) që u bë kurban i shtimit pa kufi të dhive në Dhëmban të Tepelenës. Dhite në malet tona të jugut u ngjiten pemëve më keq se vemjet dhe tashmë kanë zhdukur shumicën. Druri i prallit jeton kohën e tij më të hidhur, ndonjëherë e gjen më të shkurtër se gjysmë metri, të kthyer në një sferë që i ngjan iriqit. Asnjë farë e tij nuk ka



të drejtë të mbijë, të bëhet filiz e të lërë pasardhës, pasi sapo filizi nxjerr kokën, ajo i pritet nga kafshët shtëpiake vrastare të çdo tentative për mbijetesë. Dëshira për ndryshim të shpejtë shtoi së tepërmi tregun e ndërimit afër Tiranës, duke i shtuar kërkesat për material ndërtimi si inerte, gëlqere, etj. Kjo bëri masakrimin e shtretërve të lumenjve, por edhe të qindra hektarë pyjeve, që u prenë për t'u përdorur si lëndë djegëse për prodhimin e gëlqeres. Kryetarja e komunës së Zagorisë ankohet për tymin që i ndot ambientin e pastër e brilant, që vjen nga drutë që digjen për të prodhuar qymyr, që vazhdimisht emigron në Greqi. Shtimi i paprecedent i makinave të transportit bëri që gazrat ndotës të pushtojnë deri lartësitë e maleve e thellësitë e luginave, duke u prishur qenieve të gjalla në ato vende rrjedhën historike të jetës.

Malet shqiptare pësuan dy shndërrime rrënjësore, si prerjen e djegien masive, ashtu edhe rritjen e presionit të padukshëm të përherëshëm, që i ngjan ajsbergut, pasi ajo që shihet janë sasi të vogla druri që djeg çdo familje për dimër, si të thuash një dhuratë perëndie që nuk ka pse ti përmendet atij që jeton afër pyllit. Por

kur bashkon këtë sasi për gjithë familjet që jetojnë në fshat e që janë mbi 300 mijë, si dhe sheh organizmin tejet të dobësuar të pyllit, kjo sasi i kalon tre herë mundësitë që ka pylli dhe përbën një biznes me peshë të ndjeshme për zonat malore. Kësaj i shtohet më pas kullota e zjarri i pakontrolluar, që zhdukin farën dhe i nxjerrin brinjët malit e kodrës. Lëvizjet ambientaliste janë akoma në hapat e parë dhe protestat e tyre duket sikur janë për gjëra si të thuash “heroike”, si për ndotjet nga industritë apo organizmat gjenetiksht të modifikuara. Lëngimi dhe vdekja e paralajmëruar e pyllit nuk arrin të lexohet nga temperamentin ynë heroik, pasi ajo ishte e përditshme, e shpërndarë kudo, e pabujshëm edhe e pandalur. Atë e mbështet padija shekullore, mungesa e vizionit dhe e dëshirës për ndryshim. Duhet një zjarr i madh, pengim i tragetit në liqenin e mbushur nga erozioni të Komanit, përmbytje që të kujtohem i të zhurmojmë. Zhurma, shpesh retorike, për specie të rrezikuara të florës dhe faunës, asnjëherë nuk u konkretizua dhe nuk rriti ndjeshmërinë e medias karshi faktorit të zhdukjes së pandalshme të tërë pyllit, që është aktualisht “specia” më e rrezikuar për t'u zhdukur në Shqipëri.

Albanian Forest will have the custodian

Berisha: Need to find mechanisms to privatize forests



At the direction of Prime Minister Berisha held today meeting with the participation of ministries and institutions responsible for implementing the transfer of forests and pastures in the local government, in order to accelerate and successful realization of this process.

Considering the important meeting to further reconcile the steps to be taken by relevant institutions, Premier Berisha praised the Ministry of Environment to major and serious efforts in improving management practices, the treatment, the attitude to this problem important for each country.

Prime Minister announced that during the last 5-6 years have been transferred to local government owned about 800 thousand ha of forests and pastures, or 50 % of their fund. Considering the positive experience of forest management and grazing by local governments, the premier stressed that there is still a big job to do in terms of improvement and further consolidation of the ex-perience. "Forests are a major national asset of any country. Today they develop a tremendous importance at a time when the planet faces major climate changes and afforestation and forest are actually a powerful lever to influence possible to reduce the serious consequences of this

phenomenon. "Said the premier.

Prime Minister asked the concerned ministry and related institutions that this be the year of final settlement, in general, the problems of forest ownership.

The Premier said that it is very important as the first definition forests, which will remain public, stressing that the central government can not administer more than 10% of forests throughout the country. "The government could not be more than 10% of the forest. It is up to you, along with the dependency of select institutions that 10% of which will be, but more than that can not manage. This is a standard anywhere in the EU. This standard is that the forests belong to the communes and municipalities. "Said the Prime Minister.

Among other things, the premier highlighted that it is very important as finding the appropriate mechanisms and transparent privatization of forests, but also for their protection and development, establishing strong discipline on management. "I hope you edit a scheme not only to return in all cases to the owners of the forest, where no owner, but I would be much appreciated if you find that you will be transparent mechanisms privatization of forests, ie to

do with god woods. Of course, putting together the strongest discipline in their management. So to find the most efficient defense mechanisms and their development. "Prime minister said.

In this context, Prime Minister requested that the scheme is determined based on the expertise of the most successful countries in this regard. "I would much appreciate that you even foreign expertise can set a schedule, that we walk with the prompt return of these properties, the owners."

Considering that any land in our country can be used for planting, the prime minister stressed that all efforts should be made to develop the concept of forest with fruit trees. "We must strive to develop the concept of forest with fruit trees. This concept is taking hand-hand and world development. This method of reforestation is gaining more and more qytetarësisë right. We will do everything that is planted where produced."

Reiterating the need for faster transfer of forests and pastures, local government, and accelerate privatization of forests, the prime minister said he would be all the efforts since 2012 to find Albania among the countries with the public ownership lowest in Europe. **Page 1**

Jurant DIKA

Department for Forestry and Hunting Ministry of Agriculture, Forestry and Water Economy

I was part of the team here in Macedonia that drafted the Law on Forests. We made some mistakes, I think we will correct them during period to come, and I wish that you there in Albania don't do the same.

I recommend to have a broad discussion, and a real participatory approach to this process.

The process to be evaluated and managed responsibly and professionally

Prof. Dr. Arsen PROKO



The vision of the United Nations, embodied in the strategy and development of forest policy, aims forest for people, improve the quality of life and eradicate poverty.

Reform of Albanian forest walks to a street designated and made public through government strategies and programs. It develops in line with global and European strategies.

Decentralization and transfer of powers to local government has been a guiding principle for Albanian Government. Prime Minister in his speech calling for acceleration of the transfer / privatization of forest and pasture ... **Page 1, 2**

"Cursed Mountains" haven of ancient epos

Nijazi IDRIZI
Member of Kosovo Assembly



Our country, Kosovo, has a small area, but with a range of specifications to their distinctives, among which are Cursed a Mountains. These mountains lie, ranging from the flow of the river Ibar in the north to the Morina Neck, south, east and bordering on the flat areas of Dukagjini plain..



Cursed Mountains consist of high mountains, which reach well over 2500 m from the sea level. Highest peak is Gjeravica (2656 m) followed by slightly lower, as Lumbardh (2522 m), Ropsit (2502 m), Koprivnikut (2460 m), Hajlës (2400 m), etc.. These mountains, among them are separated by deep river gorges, such as that of Lumbardh of Peja, Decani, etc., Not only formed by tectonic movements in different

geological periods, but also by the actions of glaciers. Among the most famous glaciers has been that of Peja, which is formed by the mouth of the Rugova Gorge, with a stunning beauty in all its length of 25 km. By being such glaciers in high mountainous areas, there are many glacial lakes, among which the best known are, Lakes of Gjeravica, Lake of Leqinati, those who stand with their stunning beauty ... **Page 1, 2, 3, 4**

Comment of NACFP Board

Board of the National Federation of Forest and Pasture express special gratitude once again to the Prime Minister Berisha, who has consistently supported the decentralization process, and is seeking redress of historical injustices that have been made on these assets. Already been strengthened conviction that the transfer of responsibilities for the management of forests and pastures of the LGU, and further to traditional users, based on the ancient customary law and tradition, is very beneficial and successful, which benefit from rural poor families, who constitute half the country's population, and society as a whole ... **Page 1, 5**



Dear readers of the newspaper "Green Crown"!

We are in the preparatory phase of drafting a new law for Forests and as a very important moment we ask your support, comments, opinions and suggestions about it.

Feel free to contact us at any time without hesitating.

Contact persons:

Veli Hoxha: Redaktor Pergjegjes velihoxha@yahoo.com

Albora Kacani E-mail: alborakacani@hotmail.com

Kjo faqe u përkthye e u përgatit për botim nga Ilir KOLA

KURORA E GJELBËR

Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale, Shqipëri dhe e Asosacionit të pronarëve Privatë, Kosovë

Këshilli Botues: A. Proko, N. Çollaku, V. Tabaku, J. Male, B. Gashi, I. Zeka, B. Hoxha

Kryeredaktor: AHMET OSJA Zv.kryeredaktorë: Nijazi IDRIZI, Ferdin LIÇAJ, Albora KACANI

Redaksia: V. Muharremaj, H. Kola, Gj. Fierza, M. Shehi. Redaktor përgjegjës: V. Hoxha

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina e ZP, kati II, Tiranë

Mobile: 068 40 75 975; e-mail: fkpkk@hotmail.com; velihoxha@yahoo.com

www.fkpkk.org

www.akppp.org

